

*“Dita në të cilën pushteti i dashurisë do ta
tejkalojë dashurinë për pushtet, do të jetë dita
në të cilën bota do të gjejë paqen e vërtetë”.*

– MAHATMA GANDHI (1869 – 1945)



Kisha dhe Jeta

ORGAN I PËRMUAJSHËM INFORMACIONI I METROPOLISË TIRANË-DURRËS Nr. 8

TETOR 2016 Çmimi 30 lekë



BIJAT E MARISË NDIHMËTARE NË FESTË

Bijat e Marisë Ndihmëtare
në festë *faqe 3-4*

“Përtej reve të errëta të
mosmarrëveshjeve” *faqe 4-5*

LETËR QARKORE
E KONFERENCËS
IPESHKVORE E SHQIPËRISE
DREJTUAR MESHTARËVE,
RREGULLTARËVE DHE
RREGULLTREVË DHE TË
GJITHË BESIMTARËVE *faqe 6*

Veprimtaritë zyrtare për
Lumnimin e 38 martirëve *faqe 6*

Një notë 10 e merituar
dhe një notë 4 akoma
e pa përmirësuar për
“intelektualin” Moikom Zeqo
Nga Gjergj GJERGJI *faqe 7*

Shejtja Nanë Tereza *faqe 9*

Me gëzim dhe shpresë ia
dorëzojmë këtë vepër krejt
popullit shqiptar *faqe 10*

Në kontakt me natyrën: ditë
falënderimi ndaj Hyjit
Mbi shëtitjen në Pezë të bashkësisë së
Lëvizjes së Fokolarëve *faqe 11*

Përshkrimi i Logo-s së
Martirëve në Shqipëri *faqe 12*

Kalendari Liturgjik

Nëntor 2016

Një turmë e panumërueshme
nga të gjitha kombet
Zbulesa e shën Gjonit 7, 1-14

Pas këtyre pashë katër engjëj që qëndronin në këmbë në katër këndet e botës. Ai kishte vulën e Hyjit të gjallë. Atëherë dëgjova numrin e atyre që ishin vulosur, 144. 000 nga të gjitha fiset e bijve të Izraelit ... Pastaj pashë: një shumicë të madhe që askush s'mund e numëronte, prej çdo kombi, çdo fisi, populli dhe gjuhe! Qëndronin në këmbë para fronit dhe para Qengjit të veshur me petka të bardha e me palma në dorë. Ata shpallnin me zë të lartë: »Shpëtimi i përket Hyjit tonë që rri në fron dhe Qengjit!«

Të gjithë engjëjt që ishin në këmbë rreth fronit, rreth udhëheqësve dhe rreth katër Gjallorëve, ranë përmbyss dhe adhuruan Hyjin. Thoshin: »Amen! Bekim e lavdi, dije e falënderim, nder, pushtet dhe fuqi Hyjit tonë në shekuj të shekujve! Amen!« Atëherë njëri nga udhëheqësit mori fjalën dhe më pyeti: »Këta që janë të veshur me petka të bardha, kush janë dhe nga kanë ardhur?« Unë u përgjigja: »Imzot, ti e di!« Dhe ai më tha: »Këta janë ata që erdhën nga prova e madhe; i lanë petkat dhe i pastruan në gjakun e Qengjit.



- 1 nëntor – TË GJITHË SHENJTËRIT (Solemnitet)
- 2 nëntor – Përkujtimi i të gjithë besimtarëve të vdekur
- 3 nëntor – Sh. Martini nga Porres
- 4 nëntor – Sh. Karl Borromeo
- 5 nëntor – Të gjithë shenjtërit dhe të lumturit e Shqipërisë
- 6 nëntor – E DIELA e XXXII GJATË VITIT (C)
- 9 nëntor – Përkushtimi i Bazilikës së Lateranit
- 10 nëntor – Sh. Leoni i madh
- 11 nëntor – Sh. Martini nga Toursi
- 12 nëntor – Sh. Jozafati
- 13 nëntor – E DIELA e XXXIII GJATË VITIT (C)
- 15 nëntor – Sh. Alberti i madh
- 16 nëntor – Sh. Margarita e Skocisë; Sh. Gertruda
- 17 nëntor – Sh. Elizabeta e Hungarisë
- 18 nëntor – Kushtimi i Bazilikave të Sh. Pjetrit e Sh. Palit
- 20 nëntor – KRISHTI MBRET I GJITHËSISË (C) (XXXIV GJ.V. C.)
- 21 nëntor – Kushtimi i Sh. Marisë Virgjër
- 22 nëntor – Sh. Çeçilja
- 25 nëntor – Sh. Katerina e Aleksandrisë
- 27 nëntor – E DIELA e I E ARDHJES (A), Sh. Valeriani
- 30 nëntor – Sh. Andrea (Festë)



Drejtor i përgjithshëm:

Imzot George Frendo

Kryeredaktor:

D. Marjan Lumçi

Sekretar:

Ferdinand Ndocaj

Redaksia:

Kolec Çefa
Ana Stakaj
Zef Skanjeti
Elidon Dodaj

Grafika:

Pjerin Sheldija

Foto: Pici

Adresa:

Katedralja e Shën Palit,
Bulevardi Zhan D'Ark,
Tiranë, Shqipëri

E-mail: kisha.jeta@gmail.com

www.kishadhejeta.com

Bijat e Marisë Ndihmëtare në festë

Jemi një familje rregulltare, lindur nga zemra e Shën Gjon Boskos, dhe nga kreativiteti besnik i Shënjtës Maria Domenica Mazzarello. Don Bosko ka zgjedhur këtë emër për me: Bijat e Zojës Ndihmëtare, sepse na ka dashur si një monument të gjallë falënderimi ndaj Zojës.

Vendimi për të themeluar një Institut femëror në Torino në favor të vajzave, është bërë nga Don Bosko. Njëkohësisht në Morneze, në kodrat e Monferratos, e reja Maria Domenica Mazzarello ishte pjesëmarrëse e gjallë në një grup të rejash që i përkushtoheshin vajzave të vendit, me qëllimin për t'iu mësuar atyre një zanat, por sidomos me angazhimin për t'i drejtuar drejt jetës së krishterë.

Në distancë, dy sinjale nga e njëjta largësi dërgonin të njëjtin mesazh: duhet të krijohet edhe për vajzat ambienti edukativ që tashmë ekzistonte në Torino-Valdoko, në veprën e Don Boskos. Maria Domenica Mazzarello ishte bashkëthemeluese në krijimin dhe zhvillimin e Institutit të ri.

Në 5 gusht 1872 grupi i parë i vajzave të reja me në krye Maria Domenica Mazzarellon i thanë "PO-në" e tyre Virgjërës Mari për të qenë "Ndihmë" sidomos për të rejat.

Historia e pranisë së Institutit të Bijave të Marisë Ndihmëtare ose sic quhemi ndryshe, Motrat Saleziane fillon në Shkodër në vitin 1907.

1907-1916 Themelimi i veprave deri në dëbimin nga Shqipëria prej Austro-hungarezëve 1919-1946 Rikthimi, konsolidimi dhe zgjerimi i veprës saleziane deri në dëbimin e misionareve dhe mbylljen e kuvendeve prej diktaturës komuniste.

1946-1991 Heshtja gjatë diktaturës në të cilën Instituti është i pranishëm nëpërmjet dy motrave Shqiptare, Motër Luceta Mhilli e Motër Maria Gjomarkaj

1991-1999 Rikthimi i motrave misionare: përgjigje ndaj urgjencave dhe kërkim i rrugëve



për t'i shërbyer sa më mirë të rinjve.

1999- e sot Realizim i tri veprave: Qendrën Maria Mazzarello në Tiranë, Maria Ndihmëtare në Shkodër, Konsolidim i tyre si dhe hapjen e veprës së tretë në Tale.

HAPJA E SHTËPISË SË PARË NË TIRANË

Vepra e institutit tonë në Tiranë që në fillim është e shënuar me një mision të qartë. Me 1 dhjetor të viti 1992 tri motra na Italia në një shtëpi me qera në qendër të Tiranës, fillojnë këtë mision plot me sfida.

Pas viteve të bashkëpunimit të ngushtë (1995-1998) me etërit salezianë në themelimin dhe aktivitetinë qendërs Don Bosco në laprakë, lind edhe nevoja për të hapur një realitet më vete. Kështu në shkurt të vitit 1999 bashkëisa e motrave themelon qendrën Maria Mazzarello, në selitën e vogël. Aktivitetet e këtij realiteti

kanë lindur për të favorizuar rritjen njerëzore e shpirtërore të fëmijëve dhe të rinjve, duke u ofruar atyre kulturë, formim, edukim formal dhe informal, duke ecur me hapin e kohës, duke iu përgjigjur sfidave dhe nevojave të rritjes integrale të fëmijëve, të të rinjve dhe familjeve të reja.

Edhe sot Qendra Maria Mazzarello ose sic e qujnë të rinjtë "Maria" vazhdon të ofrojë dhe të favorizojnë një rritje shpirtërore dhe njerëzore fëmijëve, të rinjve por edhe më të rriturve, duke ofruar kopësh fëmijësh, Orator e Qendër Rinore, shtëpi për vajzat studente, katekizëm, formim për personat me të rritur. Cdo ditë shtëpia jonë frekuentohet nga qindra fëmijë dhe adoleshentë. Në këtë bashkësi aktualisht janë pesë motra; moter Teuta, motër Angela, moter Malvina, moter Jolanda dhe moter Violeta, katër prej të cilave shqiptare.





NJE PO PER TË GJITHË JETËN NE FAVOR TË TË RINJVE

Me 15 tetor 2016 Bashkëisa Edukative, motrat dhe laikët përjetuan një moment të madh gëzimi: Po- në përgjithmonë të dy motrave: Motër Jolanda Jaku dhe motër Malvina Doci.

Motër Malvina ndodhet në bashkësinë e Tiranës që prej pesë viteve dhe motër Jolanda që prej 2 viteve.

Motër Jolanda ka lindur në Sheldi (1982) dhe e rritur në Kosmaç, vjen nga një familje e Krishtere dhe e madhe. Pikërisht aty mes thjeshtësisë e perkushtimit të prindërve dhe familjareve ka kuptuar sa vlerë ka jeta, sa e rëndësishme është për familjen të vërë në vendin e

parë Hyjin.

Motër Malvina ka lindur në Pentar (1986) po ashtu në një familje të thjeshtë e punëtore, ku prania e Zotit ishte familjare, ku një fe e gjallë dhe konkrete ka qenë shembull e nxitje për të guxuar në zbulimin e Zotit.

Kështu, kur në adoleshencë, në fillim motër Malvina dhe pastaj Motër Jolanda, shkojnë në Shkodër për studime në Qendrën e motrave tona saleziane e kanë tashmë zemrën e gatshme për të kuptuar e pranuar Planin e Zotit. Në kontakt me atë ambient edukativ piqet në zemrën e secilës aftësia për ta dëgjuar Zotin dhe forca për t'iu përgjigjur. Kështu pas dy vitesh fillojnë ecjen e tyre përgatitore për t'u bërë motra saleziane për t'ia dhuruar jetën Zotit dhe të rinjve. Secila në vitet në vijim ka përshkuar një rrugë të ndryshme në bashkësi të ndryshme për t'u formuar si shpirtërisht ashtu edhe profesionalisht për misionin që i pret. Që atëherë kanë kaluar me shumë se dhjetë vite. Sigurisht të ndjekësh Zotin është një aventurë marramendëse, që të nxjerr nga cdo siguri e mëparshme, por hap pas hapi, krahas me qartësinë e kërkesave të Tij, është rritur edhe vetëdija se duke ia dhuruar jetën Hyjit, gjejmë edhe forcën për të mos ngurruar para vështirësive.

Angazhimi gjatë këtyre viteve dhe aktualisht në bashkësinë e Tiranës, perkushtimi ndaj fëmijëve dhe të rinjve, dëshira për të gjetur e për të bërë vullnesën e Zotit edhe kur kjo nuk ishte kaq e lehtë, por pa e humbur buzëqeshjen, dashuria për Kishën, për Institutin dhe për të rinjtë e fëmijët, janë garancia që jetët e tyre të jenë të gatshme të dhurohen përgjithmonë Zotit të jetës. Ka ardhur tashmë momenti që



Po-ja që në zemër i kanë thënë Zotit që në 2010 të bëhet e dukshme, solemne për t'i dëshmuar popullit që Hyji e do popullin e vet dhe thërret persona që të bashkëpunojnë me të për shëlbimin e të gjithëve.

Sigurisht Jezusi nuk do t'u kursejë vështirësitë e sacrificat. Ai i ka thirrur të bashkëndajnë me të dashurinë e perkujdesin për të rinjtë, që ata ta kenë gëzimin e Ungjillit, por prania e Tij nuk do t'ju mungojë. Ndaj këtë "Po" do ta përsërisin çdo ditë në zemër e në veprat konkrete që gëzimi i të rinjve të jetë i plotë.

Në këtë aveniment morën pjesë përveç një mori e madhe të rinjsh, familjesh, miqsh të qendrave tona. Ata së bashku me dy motrat me Institutin e Bijave të Marisë Ndhimëtare falenderuan Zotin me gëzim për dhuratën e madhe të thirrjes.

“Përtej reve të errëta të mosmarrëveshjeve”

Papa dhe Primati anglikan sëbashku sikurse 50 vite më parë

Zërat e këngëtarëve të *Kapelës Sistine* e Zata të Korit të *Canterbury-t*, shkrihen në një melodi të vetme mes pamjeve të stilit barok të Kishës Romake të *Shejtërve Andrea e Gregor në Qiell*. Në ajri kumbojnë psalmet në latinisht e në anglisht. Në Kishë, pak hapa larg nga Koloseu, këtë pasdite përjetohet *amarcord-i* i një çasti historik.

Në të vërtetë dita e 23 marsit të 1966 që pa në Vatikan takimin mes, arqipeshkvit në atë kohe të *Canterbury-t* Michael Ramsey dhe Papës Pali VI, i cili me një përqaftim të kremtuar nën *Giudizio Universale*, i dha limfë të re një miqësie të errësuar nga ngjarjet e vështira historike. Ishin pesë shekuj që primati i kishës anglikane nuk po i lëkundte muret leonine, e fryti i parë - ky takim përtej bashkimit të rigjetur - që Instituti i ngritur në Qendrën Anglikane të Romës.

Tani, pas një gjysëm shekulli, ekziston një dialog i qartë dhe i kultivuar ndër vite. Papa Françesku e l'arqipeshkvi Justin Welby e rijetojnë këtë ngjarje, duke kremtuar sëbashku



Vespret madhështore, në të njëjtën Kishë ku 1400 vite më parë Papa Gregori dërgoi Shën Agustinin e *Canterbury-t* e murgjit e tij tek njerëzit anglosaksonë.

E lexuar dhe e firmuar gjatë liturgjisë është edhe një Delaratë e përbashkët, gjatë së cilës

Papa e arqipeshkvi dorëzojnë një mandat të përpiktë ekumenik, drejtuar mbi të gjitha, 36 ipeshkvijve katolikë e anglikanë të dërguar dy nga dy për t'iu përgjigjur zbatimit të thirrjes së Papës që të ecin sëbashku si një entitet i vetëm.

Ka qenë një ftesë e ndërmarre nga Papa

edhe gjatë omelisë së tij, në të cilën porositi për të qenë “promotorë të një ekumenizmi të fortë e real, gjithmonë drejt ecjes në kërkimin e hapjes së shtigjeve të reja” prej të cilave do të kenë beneficet pikë së pari Provincat e pastaj edhe Konferencat Episkopale.

Shembulli emblematic ka ndodhur që në Edimburg, me Konferencën e shoqërisë misionare, e cila i dha urdhërin lëvizjes ekumenike: “Që pikërisht zjarri i misionit që lejoi të nisë kapërcimi i stekave e shembjen e rethimeve që izoloni dhe e bënë të paimagjineshëm ecjen e përbashkët”, të sjellur ndër mend.

Papa sugjeron kështu “metodologjinë baritore”, të zbatuar sipas një rrugëzgjdhje kur Zoti shkon në kërkimin e deles së humbur, e gjen, ridrejton për në vathë, i fashon plagën dhe i kuron sëmundjen. “Vetëm kështu mbledhet populli i shpërndarë” gjatë atyre “ditëve të mjegullta e me turbullirë” për të cilat flet profeti Ekzekieli, kur ne “kemi humbur nga sytë vëllain që na qëndronte përbri dhe jemi bërë të paafte për t’u rinjohur e për t’u gëzuar me dhuratat tona respektive si dhe me hirin e marrë”.

Nëpërmjet fjalëve elokuate të profetit, “Hyji – nënvizon Françesku – na jep një mesazh të bashkimit: aq Baritor, sa ç’dëshiron bashkimi në popullin e tij e sa ç’do të dëshirojë që mbi të gjitha Barinjët të shpenzojnë për këtë”.

Pra dëbohen ato re që “u dendësuan, përrreth nesh”, “re të errëta të mosmarrëveshjeve e të grindjeve, të formuara shpesh prej arsyeve historike e kulturore dhe jo vetëm për motive teologjike”. Shkofte tutje edhe ajo “mjegull e moskuptimit dhe e dyshimit” për t’i lënë vend “sigurisë së qëndrueshme kur Hyji do të banojë mes nesh, grigja e tij dhe thesari i çmuar”.

Ai, pohon Papa, na inkurajon “për të ecur drejt një bashkimi më të madh, që mund të arrihet vetëm me ndihmën e hirit të tij”. “Kjo ecje e bashkimit është udha më e shkurtër për të gjithë të krishterët dhe është misioni juaj i veçantë, sa i takon Barijve të Komisionit Ndërkombëtar anglikan-katolik për bashkimin e misionin”, evidenton Papa. “Është një thirrje e madhe ajo për të vepruar si instrumente të bashkimit përherë e ngado”, e cila do të thotë “në të njëjtën kohë të promovosh bashkimin e familjes së krishterë e bashkimin e familjes njerëzore”.

Për ta bërë këtë gjë nevojitet të ofrojmë “shërbimin tonë në mënyrë të përbashkët, njëri përbri tjetrit”, që të promovojmë “hapjen dhe takimin, duke ngadhënjyer mbi tundimin e mbylljeve dhe izolimeve”, për të operuar “bashkëkohësisht si në favor të bashkimit të të krishterëve si të familjes njerëzore”.

“Rinjihemi si vëllezërit që u përkasin traditave të ndryshme, por që janë të shtyrë nga i njëjti Ungjill të ndërmarrin të njëjtin mision nëpër botë”, vëren Papa. Një gjë e tillë na sugjeron dy pyetje, para se të ndërmarret ndonjë veprimtari. “Përse mos ta bëjmë këtë së bashku me vëllezërit tanë Anglikanë? A mund



ta dëshmojnë Jezusin duke vepruar së bashku me vëllezërit tanë katolikë?”.

Në fakt janë të shumtë “të humburit e sotëm” që nuk e njohin dashurinë e Krishtit, qengjit të flijuar për botën i cili simbolizohet nga shkopi baritor që Bergoglio i ka dhënë Welby-t. Ky është “mesazhi i vërtetë inovativ për ta çuar përpara së bashku”, thotë, “mbarëshkrimi ynë konsiston në ndriçimin e errësirave me këtë dritë të butë, me forcën e padhunë të dashurisë që ngadhënjën mbi mëkatin dhe mposht vdekjen.”

“Kemi kënaqësinë për ta rinjohur dhe për ta festuar së bashku thelbin e besimit”, shton Papa. “Qendërohem në të, pa u hutuar nga ajo sa përfshihemi për të ndjekur shpirtin e botës, e cila do të donte të na hiqte nga freskia origjinale e Ungjillit”. Pikërisht prej atje “buron përgjegjësia jonë e përbashkët”, apo misioni i ndihmës së grigjës “që të jetë në dalje, në lëvizjen në shpallje të gëzimit të Ungjillit; jo e mbyllur në qarqet e ngushta, në “mikroklima” ekleziale që do të na çonin në ditët e reve dhe të errësirës së dendur”.

Në deklaratën e përbashkët të nënshkruar në fund të kremtimit, pas shkëmbimit të dhuratave dhe bekimit të ipeshkvijve, Françesku e Welby u ndjenë të inkurajuar në rrugën e dialogut, edhe pse “nuk shohim ende zgjidhje për pengesat para nesh”. Midis tyre llogariten urdhërimi i grave dhe më të vonshmet çështjet që lidhen me seksualitetin e njeriut. Divergjencat, gjithësesi, siç lexohet në tekst, “nuk duhet të pengojnë lutjen tonë të përbashkët: jo vetëm që ne të lutemi së bashku, por ne duhet të lutemi së bashku duke i dhënë zë besimit dhe gëzimin që ndajmë në Ungjillin e Krishtit”.

“Në veprimet tona së bashku, bota duhet të na shohë e të dëshmojë këtë besim të përbashkët në Jezusin”, pohojnë më pas Papa

e arqipeshkvi në pasazhin më domethënës të Deklaratës. “Mundemi dhe duhet të punojmë së bashku për të mbrojtur e për të ruajtur shtëpinë tonë të përbashkët: duke jetuar, duke mësuar e duke vepruar në mënyrën që favorizon fundin e menjëhershëm të shkatërrimit mjedisor, i cili e fyen Krijuesin dhe i degradon krijesat e tia, duke gjeneruar modele të qëndrimeve individuale e sociale që promovojnë një zhvillim mbështetës e integral për të mirën e të gjithëve”.

“Mundemi, dhe duhet, të jemi të bashkuar në çështjen e përbashkët të mbështetjes dhe mbrojtjes së dinjitetit të gjithë njerëzve”, veçanërisht “nga kultura e indiferencës” në të cilën “muret e tjetërsimit na izolojnë nga të tjerët, nga luftërat e tyre e nga vuajtjet e tyre, që edhe shumë vëllezër e motra tona në Krishtin po i heqin sot”. Pastaj nga “Kultura e shkapërderdhjes”, ku “jetët e më të dobtëve në shoqëri janë shpesh të marginalizuara e të përjashtuara”. Një “kulturë e urrejtjes “në të cilën “asistojmë në akte të patregueshëm të dhunës, shpesh të justifikuar nga një kuptim i shtrembëruar i besojmës fetare”.

Dy liderët religjiozë përforcojnë pra zotimin “për të mirënjohur vlerën e paçmuar të çdo jete njerëzore dhe për ta nderuar atë nëpërmjet veprave të mëshirës, duke ofruar mësim, kura sanitare, ushqim, ujë të pastër e strehë; gjithnjë duke kërkuar që të zgjidhen konfliktet e të ndërtohet paqja”. Dhe kjo sepse “ndërsa si dishepuj të Krishtit e mbajmë personin njerëzor të shenjtë e ndërsa si apostuj të Krishtit duhet të jemi avokatët e tij”. Prandaj “Katolikët e Anglikanët do të punojnë së bashku për t’i dhënë zë besimit të përbashkët në Zotin Jezu Krisht, për të çuar lehtësim në vuajtje dhe paqe atje ku është konflikti”.

LETËR QARKORE E KONFERENCËS IPESHKVORE E SHQIPËRISE DREJTUAR MESHTARËVE, RREGULLTARËVE DHE RREGULLTREVË DHE TË GJITHË BESIMTARËVE

Fort të dashur,

I jemi shumë mirënjohës Zotit i cili sivjet na ka mbushur me shumë gëzim kur, nëpërmjet Papa Françeskut, ka ngritur emrin e së Lumës Terëza ndër emrat e shenjtëve të Kishës. Dhe sikur kjo të mos mjaftonte, pas disa ditësh Kisha do të shkruajë në albumin e te Lumëve emrat e tridhjetë e tetë katolikëve që kanë pësuar martirizimin në periudhën e errët e komunizmit ateist.

Shën Toma Akuini e përkufizon martirizimin si "derdhjen e gjakut të dikujt për hir të Krishtit" dhe si "qëndresën e duhur ndaj vuajtjeve të shkaktuara padrejtësisht". Fjala "martir" do të thotë "dëshmitar". Prandaj martiri është ai që jep dëshmi të besimit të tij. Jezusi tha: "Dashuri më të madhe nuk ka, sesa ajo e një njeriu që jep jetën për miqtë e tij" (Gjn 15, 13). Kështu martirizimi është shfaqja më supreme e dashurisë së Krishtit. Papa Gjon Pali II ka deklaruar se martirizimi i krishterë "e ka shoqëruar gjithmonë dhe vazhdon të shoqërojë jetën e Kishës, edhe sot".

Komunizmi që, për gati një gjysmë shekull, ka sunduar Shqipërinë, shfaqti një urrejtje të veçantë ndaj katolikëve. Në një fjalim që Enver Hoxha bëri në Konferencën e Pezës, në vitin 1984, tha: "Hierarkët katolikë ishin njerëz pa atdhe, vareshin plotësisht nga Vatikani ... Të gjithë hierarkët e kishës katolike ... ishin të mësuar, të shkolluar me shkollë teologjike, me disiplinë të hekurt, me metodat dhe dredhitë e shtypjes së vullnetit të njerëzve me frikën e zotit ... Kisha katolike dhe hierarkia e saj ishin në kulm obskurantistë, konservatorë ... gjithmonë në aleancë me regjimin reaksionarë ..." Janë fjalë që tregojnë paragjykimet e tij kundër Kishës Katolike.

Toka shqiptare u lag me gjakun e martirëve. Por sot gëzohemi se, më 5 nëntor, Kisha do të ngrejë mbi altaret tona tridhjetë e tetë martirë të vrarë në atë periudhë të tmerrshme. Të gjithë këta ishin priftërinj (ose klerikë), me përjashtim të katër laikëve: një vajzë, Marije Tuci, e vrarë barbarisht sepse ajo ishte kandidate e Motrave Stigmatine dhe katekiste;

dhe tre burra, Mark Çuni, Qerim Sadiku dhe Gjëlosh Lulashi. Renditur i pari në mesin e dëshmorëve është Vinçenc Prendushi, ipeshkvi i fundit i Durrësit. Ai u akuzua si "armik i popullit", "reaksionar", "spion i Vatikanit", dhe u dënua me njëzet vjet burgim, ku ai ishte torturuar, fyer dhe poshtëruar në mënyra nga më të ndryshmet, derisa vdiq.

Në një fjalim të tij, Papa Pali VI pyeti: "Çfarë nevojë ka Kisha sot?" Dhe ai vetë përgjigjej duke thënë se në rrethanat e tanishme "Kisha ka nevojë për burra të fortë", që do të thotë, njerëz të pajisur me virtytin e guximit. Shën Pali i kishte paralajmëruar tashmë të krishterët e Romës duke u thënë: "Mos u konformoni me këtë botë", që nënkupton se jeta e krishterë gjithmonë nënkupton një luftë kundër një mentaliteti të një bote që përpiqet ta përjashtojë Zotin.

Të dashur vëllezër e motra, Kisha ka nevojë për dëshminë tuaj. Kisha ka nevojë që disa të rinj dhe të reja ti kushtohen Zotit në jetën meshtarake dhe rregulltare. Shoqëria, veçanërisht sot, ka nevojë për dëshminë tuaj. Kini parasysh shembullin e martirëve tanë. Fjalët e fundit të tyre ishin: "Rroftë Krishti Mbret! Rroftë Shqipëria!" Dashuria besnike ndaj Zotit na mëson si të duam atdheun, si të duam të tjerët, po ashtu edhe si të duam vetveten. Sepse njeriu nuk mund ta mohojë Zotin pa mohuar njëkohësisht vetveten. Pra të angazhohemi për të qenë qytetarë të mirë dhe të drejtë në familje, në shkollë, në çdo sektor e jetës edhe në politikë. Të tregohemi të fortë në besimin tonë, që nëpërmjet nesh bota të mësojë të respektojë jetën njerëzore që nga ngjizja deri në vdekje dhe të angazhohemi për atë drejtësi që është themeli i një paqeje të vërtetë dhe të qëndrueshme.

Ju presim te merrni pjesë në kremtimin e Lumnimit të martirëve tanë të shtunën më 5 nëntor, në Shkodër në orën 10.00.

Ju përcjellim me bekimin tonë baritor.

Ipeshkvi tuaj

Veprimtaritë zyrtare për Lumnimin e 38 martirëve

Lajmi i shpalljes së datës së "Lumnimit të Imzot Vinçenc Prenushit me 37-shokët e tjerë martirë", ndezi e ngrohu zemrat e çdo besimtari duke i kaluar permasat e Kishës lokale dhe kombëtare. Njohja zyrtare nga Kisha Universale e martirizimit të tyre, përveçse ngre në altaret e çdo Kise heroizmin fetar, është edhe një shenjë mirënjohje për të gjithë ata burra, gra, pleq e fëmijë të cilët, si pasojë e një ideologjie ateiste, u dënuan padrejtësisht duke pësuar tortura nga më çnjerëzoret që shekulli i kaluar kishte njohur.

Ky vit Jubilar Mëshire, pa ndrojë është viti i Kishës në Shqipëri. Shenjtërimi i Nënë Terezës, shpallja dhe emërimi i Kardinalit të nderit, dom Ernest Troshani si dhe shpallja e Lumnimit të Martirëve me datën 5 Nëntor dëshmojnë fuqishëm se Zoti nuk e braktis kurrë popullin e vet, dhe se Verteta do të ngadhënjë gjithmonë.

Kjo bindje ishte muza e atyre që përballë vuajtjeve e torturave zgjodhën të shpallin fuqinë



e Zotit që fal. Gjaku i derdhur është heroizimi që lartëson forcën e besimit dhe dëshmon pushtetin e së Mirës dhe së Drejtës që nuk thyhet dhe nuk i nënshtrohet së keqes, sado e madhe dhe e fuqishme të jetë ajo. Rroftë Krishti Mbret, Rroftë Shqipëria, i fali ato që më kanë bërë keq dhe që do të më pushkatojnë të shqiptuara në çastet e fundit të jetës, ndërsa breshërit e automatikëve prisnin të fundit komand për tu shprazur, vertetojnë forcën e madhe fetare, shpirtërore dhe njerëzore me të cilën ishin të ushqyer martirët shqiptar.

CEREMONIA E LUMNIMIT

Sikurse tashmë jeni në dijeni, Mesha Shenjtë e Krenimit Liturgjik, do të celebrimet në Katedralen "Shën Shtjefni" në Shkodër. Ky celebrim do të udhëhiqet nga Hirësia e Tij Kardinali i Kongregatës për Çështjen e Shenjtërve Angelo Amato.

Sigurisht, për një ngjarje të tillë, asnjë ambient nuk do të ishte i mjaftueshëm për të mikpritur besimtarët e shumë të sdo ja lejonin vetës të humbnin këtë ditë historike. Për t'ju dhënë të gjithëve mundësinë e përjetimit të kësaj ngjarje, në sheshin përballë Katedrales, Sheshi Gjon Pali II, do të instalohen ekrane të mëdhenjë që do të transmetojnë gjithë Krenimin.

Për të na nderuar dhe për të qënë afer nesh në këtë Krenim Solemn, përveç kardinalit udheheqës, i derguari i Papa Franceskut, Angelo Amato, do të jenë të pranishëm; Kardinali i jonë d. Ernest Troshani, kryetar i Konferencës Ipeshkvoe të Italisë, Kardinali Angelo Bagnasco; ipeshkvi i Kelnit, Kardinali Ranier Maria Woelki; Kardinali Salvatore de Giorgi, nga

Roma; Ipeshkvi i Napolit, Kardinali Crescenzo Sepe.

Do të jenë të pranishëm në bashkëkrenim 20 ipeshkvinj nga vende të ndryshme të botës; si dhe rreth 300 meshtarë nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, diaspora dhe vende të tjera të botës.

Besimtarëve të shumtë që do ngarendin për të marrë pjesë në këtë krenim solemn, nga Shqipëria, do u shtohen edhe besimtarët e tjerë nga Kosova, Mali i Zi, Kroacia dhe mbarë diaspora shqiptarë nëpër botë.

Për të nderuar këtë krenim janë të ftuara autoritetet më të larta shtetërore si nga Shqipëria ashtu edhe nga Kosova.

Kisha Katedrale do jetë e hapur për të gjithë, të vetmet vende që do të rezervohen do të jenë për familjarët e martirëve dhe për autoritetet e larta shtetërore.

I gjithë krenimi do të transmetohet nga Televizioni publik Kombëtar TVSH. Cdo media që dëshiron të transmetojë live do të ketë mundësi të lidhet në frekuencat që TVSH do vë në dispozicion.

Në lidhje me sigurinë, forcat e policisë do të angazhohen për mbarvajtjen sa më të mirë të Meshës së Shenjtë.

Në pritje të kësaj ngjarje, për një përgaditje sa më dinjitoze, Komisioni i KISH-it i ngritur për këtë rast, ka përgaditur një seri veprimtarish/aktivitetesh si më poshtë:

PROGRAMI I AKTIVITETEVE KULTURORE DHE FETARE.

• Me datën 26/10/2016, në orën 18.30-Promovimi i librit: "Imzot Vincens Prenushi me shokë martirë" në sallën Mikel Koliqi, dhe me

datë 31/10/2016 i njëjti promovim do të jetë në Tiranë, në orën 11.30 pranë ambjentëve tek Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë".

• Me datën 27/10/2016, në Emisionion në Top Story, në Top Channel "Ecuria e Proçesit të martirëve", në studio Mons. Angelo Massafra.

• Me datën 29/10/2016, ora 19:00, Koncert në katedrale. Interpretin Kori i katedralës, dirigjent(Lukë Mllugja).

• Me datën 31/10/2016, ora 18:30, salla Kardinal Mikel Koliqi do të mbahet dramatizimi me temë "Fajtor të pa faj", i përgaditur nga Seminari Nerdioqezan Shqiptar në bashkëpunim me dirigjent Zef Coba.

• Me datën 03/11/2016, ora 17:00, në Katedrale, Koncert me pjesëmarrjen e korit "Prenke Jakova", dirigjent Gjon Shllaku.

• Me datën 4 Nentor, ora 10:00, në përkujtim të 26- vjetorit të Meshës së Parë, në Varrezat e Rrmajt do të kremtohet Mesha e Shenjtë.

• Në Vigjilje të Krenimit të Meshës së Lumnimit të 38-Martirëve, së bashku me autoritetet më të larta Kishtare, në Kishën e Shën Franceskut "Gjuhador" do të jetë lutja e Mbremesores në orën 18.00.

AKREDITIMET

Sa i përket kësaj pike; të gjithë fotoreporteret, kameramanët dhe gazetarët, janë të lutur që të akreditohen pranë faqës se Web-it; www.katedraljashkoder.com, duke klikuar tek zëri "Akreditimet për Martirët". Akreditimi tek webi do të jetë kusht i domosdoshëm për të pasur akses.

Komisioni për mediat, Dom Artur Jaku & Dom Mark Shtjefni

Një notë 10 e merituar dhe një notë 4 akoma e pa përmirësuar për "intelektualin" Moikom Zeqo

Nga Gjergj GJERGJI

Siç çdo shqiptar që Gjergj Kastriotin Skënderbeun e konsideron dhe e nderon si Hero Kombëtar, kam ndjekur me vëmendje reagimet në shtypin e shkruar shqiptar të disa intelektualëve tanë ndaj një farë historiani turk, Talha Ugurluel (ogurzi) që mund të jetë një "kamikaz historik", por historian kurrsesi. Thjesht, një shtetas turk që ka rënë në "gjak" me historinë dhe të vërtetën...

Të tillë denigrues të Heroit tonë Kombëtar, Skënderbeut, Kadare i quan "mohsa" që mjerisht ndër ta ka edhe shqiptarë.

Që të mos zgjatet e ta mërzis lexuesin, po sjell këtu një thënie të shkencëtarit të madh francez, Blez Paskal që mendoj se i përshtatet kontekstit:

"E vërteta është aq e errësuar në këto kohë dhe gënjeshtër aq e mirëvendosur, sa që po nuk e deshëm të vërtetën, zor se do ta njihnim".

Një ndër këta reagime të nevojshme e të vëra ishte edhe intervista e intelektualit Moikom Zeqo e botuar në gazetën "Koha Jonë" me datën 8 korrik 2016 që e meriton vlerësimin me notën



10. Zeqo, gjatë intervistës propozon me të drejtë që Figura e Gjergj Kastriotit Skënderbeut të ketë "Mbrojtje kushtetuese".

Në vijim të po kësaj interviste, pyetjes së gazetarit se:

Çfarë na bashkon ne shqiptarët, Zeqo i përgjigjet:

"Ne themi se na bashkon gjuha. Por, gjuha edhe mund të na ndajë, sepse me të njëjtën gjuhë edhe shahemi me njëri-tjetrin, në mënyrë të skajshme. Atëherë çfarë na bashkon? Janë disa figura, të cilat në mënyrë konsensuale janë të përbashkët për të gjithë ne, pavarësisht ideve politike. Është Skënderbeu, Marin Barleti, Gjon Buzuku, Onufri, Pjetër Bogdani, Fan Noli, Faik Konica, Gjergj Fishta, Naim Frashëri, De Rada, Migjeni etj. Ne quhemi shqiptarë, sepse në kujtesën tonë janë këta emra".

Me shumë të drejtë z. Zeqo rreshton një plejadë personalitetesh që na bëjnë të ndjehemi krenarë që jemi bashkëkombas me Ta.

U gëzova shumë kur në këtë plejadë pashë edhe emrin e At Gjergj Fishtës, kandidati i parë shqiptar për çmim Nobël në letërsi e qysh në

nëntor 2002, Nderi i Kombit (me vonese, por gjithsesi më mirë vonë se kurrë).

Nuk mund ta di nëse z. Zeqo e ka harruar një poezi (nëse mund të quhet e tillë) që ai ka botuar në gazetën "Drita" me 30 tetor 1983, me titull "Funerali", ku At Gjergjit mjerisht i denigrohet "Udhëtimi i fundit i trupit të Tij mbi tokë, pra funerali".

Kam 33 vjet që e ruaj këtë gazetë, nuk kam mbaruar fakultet për Gjuhë-Letërsi, por e bukura në art, muzikë e letërsi më ka tërhequr qysh në rinë, prandaj në ato vite (1975 - 1992) abonohesha në gazetën "Drita", e cila edhe pse e censuruar si i gjithë shtypi i asaj kohe, shpesh kishte tregime e poezi me vlera nga autorë vendas e më rrallë, edhe të huaj.

Poezinë po e paraqes pa i hequr asnjë presje.

FUNERALI

Funerali i Fishtës me katafalkun grandioz, mbi katafalk një kryq i madh dhe i zi, dekoratat e papës dhe tre perandorëve vajtimi dhe litanirat priftërore në kllapi.

Ekstazë fetare,
Franceskanëve në rreshta
nga brezi litari karakteristik u varej,
kufoma idol në përfytyrim do t'u mbetej
në mënyrë arkaike munifikuar në vargje.

Pas të vdekurit në krye vetë Jakomoni,
mes qirinjve të mëdhej e të ndezur
nënmbnreti fashist - një i vdekur i gjallë
i krejt perandorisë që kish për të vdekur.


Në atë muzg okupacioni
ky funeral priftërinjsh
shkelte mbi dramën e popullit e dhimbjet,
si trekëmbësh
kryqi i katafalkut të zi
lëkundte litarin e nëmur të Fishtës!

Sinqerisht më vjen keq për lëndimin që mund të ndjejë z. Zeqo nëse e lexon këtë shkrim. Kisha dëgjuar e lexuar për dhunim kufomash, varresh, por për denigrim funerali kurrë. Kam rreth 50 vjet që për veprën letrare të At Gjergjit kam dëgjuar e lexuar. Mbaj mend se u pikëllova shumë kur e lexova atë "po e zi", e se kujt po i denigrohej funerali, bash Atij që në vitin 1902, poezinë "Atdheu" e përfundon me vargjet:

...Dersa t'mundem me ligjrue
E sa gjallë me frymë un jam,
Kurr, Shqypni, s'kam me t'harrue
Edhe n'vorr me t'permendë kam.

Mbasi jemi në pikun e diskutimeve për Reformën në Drejtësi, po sjell në vëmendjen e lexuesit një fragment nga poema satirike "PALOKË CUCA" e shkruar në vitin 1922, ku At Fishta vë në pah rëndësinë jetike dhe përgjegjësinë e madhe që kanë njerëzit e drejtësisë për mbarëvajtjen e një vendi...

"Der sa gjyqtari e syni i tij avokati,



Mos t' kenë kuptue shejtninë e detyrës s' vet
Që para n' skam me ra ata t' jenë gati
Se me iu shmang Drejtësisë e Ligjës, një shtet
Nuk përparon, jo kurrë, e atij i bardhë fati
S' ka për t'iu reshë as n' fshat as n' qytet..."

Vlerësim jo objektiv për veprën e At Fishtës deri në vitin 1991 ka pasur edhe I. Kadare, por ka 25 vjet që kandidati për Çmim Nobel në letërsi (uroj që ta marrë këtë vit, në 80 vjetorin e Tij) ka ndyshuar mendim e ka bërë «mea culpa» për veprën e Fishtës sa që në librin e tij, MOS-MARRVESHJA, mbi raportet e Shqipërisë me vetveten, sprovë letrare, botim i ONUFRI-t, 2010, në faqen 38, shkruan: Gjergj Fishta është rilindës. Ai është shpëtues si gjithë rilindësit. Ai është më tepër se aq, ai është shëlbues. (them se komenti është i tepërt).

Për analogji, shpresoj se edhe Ju z. Zeqo do të kërkonti ndjesë nëse e ndjeni. At Gjergji, në Kishën Franceskane në Shkodër, aty ku Ai sapo u emrua Drejtor i Kolegjit Franceskan në vitin 1902, hoqi gjuhën italiane si gjuhë të parë mësimi dhe vuri gjuhën shqipe që aq mahnitshëm e lëvroi në lirikë, epikë, satirë e publicistikë për 40 e sa vjet.

Aty, në atë Kishë, Poeti ka të muosura disa eshtra të dorës që për mrekulli, si për të treguar vlerën e asaj dore për çfarë shkroi Ai për gati gjysëm shekulli, mbetën pa u hedhur në lumin Drin me pjesët e tjera. Siç duket «autoritetet» e padenjë të asaj kohe nuk donin që Poeti të vazhdonte të «përmendte» Shqipërinë, por Partinë...

Ç'makabritet i antivlerave njerëzore dhe i ur-rejtjes patologjike e jo vetëm politike i Diktaturës Komuniste...

Z. Zeqo, nëse e ndjeni se jeni penduar për atë poezi, do të ishte mirë që të shkoni në atë vend të shenjtë e të kërkonti të falur e At Gjergji me siguri do t'Ju falë. Ai në të gjallë të Tij ka falur gjakun e vëllait të vvarë.

E Ju do të ndjeheshit i lehtësuar.

GJAKU I NJË FETARI

Në kohë të regjimit,
dënojnë një meshtar,
duke i thënë shkaku:
- Ti je besimtar!

E rrahën të gjorin,
shpinës i japin dru.
Nga burgu s'do dalësh,
fenë pa e mohu'.

I thonë: Shkele Kryqin!
Do të dalë më mirë.
E kështu së shpejti,
do të jesh i lirë.

S'mendojnë të mjerët,
bijtë e robërisë,
se është vetë Kryqi,
shenja e lirisë.

Papritmas meshtari,
Kryqin përqafoi.
Bam! – krisi pushka,
në ballë e qëlloi.

Gjaku i derdhur,
bukur në mur shkroi:
Për Krishtin vdiqa,
me Krishtin jetoj.

Nikolin Sh. Lëmezhi
Shkodër, nëntor 1996

Shejtja Nanë Tereza



Hyji e ka krijuar secilën qenie njerëzore për një qëllim të vetëm: të duaj dhe të ndjehet i dashur.



E ndjej se sot shkatërrimtari më i madh i paqes është aborti, sepse është një luftë e drejtpërdrejtë, një vrasje e drejtpërdrejtë, një vrasje e drejtpërdrejtë me dorën e vetë nënës. [...] Atëherë nëse një nënë mund ta vrasë fëmijën e saj, s'ka asgjë më që të mund të ndalojë mua që të të vras ty apo ty të më vrasësh mua.



Do të mungoj vazhdimisht në Parriz, për t'ju ndezë një dritë atyre që jetojnë në errësirë në tokë.



Shumë flasin për të varfrit, por pak flasin me të varfrit.



Zojës së bekuar ju desh të boshatisej përpara se të mbushej me Hir. Ju desh të deklarohet se ishte skllave e Zotit përpara se Hyji ta mbushte me Hir. Kështu edhe neve duhet që më përpara të boshatisemi nga çdo lloj krenarie, nga çdo xheloz, nga çdo egoizëm, përpara se Hyji të na mbushi me Hirin e tij.



Njerëzit që shkruajnë për mua, dijnë më shumë se sa di unë për vetveten time.



Përvujtëria është fillimi i shenjtërisë



Unë nuk jam asgjë tjetër veçse një laps i vogël në dorën e Hyjit. Është Ai që shkruan. Është Ai që mendon. Është Ai që vendos. E përsëris: nuk jam veçse një laps i vogël.



Unë e shikoj, Ai më shikon. Ja lutja e përsosur.



Zoti nuk mund të bëjë asgjë për atë që është plot me vetveten.



Kam zgjedhur të kem emrin Tereza, jo për atë të madhen Tereza d'Avila, kam zgjedhur emrin e Terezës së vogël: Tereza e Lisieux.



Kam filluar ti dua errësirat e mia sepse besoj se janë një pjesë, një pjesë e vogël e errësirës së Krishtit dhe e mundimeve të Krishtit mbi tokë.



Jam vetëm një vegël e Jezusit: pse interesoheni më shumë për mua sesa për veprën e Tij?



Sa e dhimbshme është të jetosh pa Zotin.



Për mua është shumë e qartë: Gjithçka që kanë Misionaret e bamirësisë ekziston vetëm për të shuar etjen e Krishtit.



Biri im, pa Zotin jemi shumë të varfër për tu shërbyer të varfërve! Kujtohu se unë jam thjesht një grua e varfër që lutet.



Shenjtëria e vërtetë është kjo: të kryesh vullnetin e Hyjit me buzëqeshje.



Gëzimi është një rrjetë dashurie për të kapur shpirtrat.



Të gjithë duhet ta njohin se çfarë është varfëria. Njerëzit tanë ndoshta kanë shumë të mira materiale, mbase kanë gjithçka, por mendoj se nëse shohim brenda shtëpive tona, vërejmë se është shumë e vështirë të gjejmë një buzëqeshje dhe buzëqeshja është fillimi i dashurisë.



Ajo që ne bëjmë është vetëm një pikë uji në oqean, por nëse nuk do ta bënim oqeani do të kishte një pikë më pak.



Nuk do të arrijmë kurrë që ta kuptojmë se çfarë të mire të madhe mund të dhurojë një buzëqeshje.



Nëse dëshiron të ngjitesh deri në qiell, duhet të zbresësh deri tek ai që vuan dhe ti japësh dorën të varfrit.



Sekreti im është shumë i thjeshtë. Lutem. Përmes lutjes, bëhem një gjë e vetme në **dashuri me Krishtin**. Ta lusësh Atë do të thotë ta duash Atë.



Është më lehtë të shuash urinë për bukë sesa urinë për dashuri.



Zoti vepron gjithmonë nëpërmjet rrugëve të thjeshta.



E kuptova se dashuria përfshinte në vetvete të gjitha thirrjet, që ishte gjithçka, që përfaqëonte të gjitha kohët e të gjithë vendet. Thirrjen time përfundimisht e kam gjetë... është dashuria!



Fjalët bujare janë të shkurtra dhe të thjeshta për tu thënë, por jehona e tyre është e amshuar

Me gëzim dhe shpresë ia dorëzojmë këtë vepër krejt popullit shqiptar

PREZANTIMI I DY VELLIMEVE MBI MARTIRET
NE TIRANE, TEK UNIVERSITETI KATOLIK -ME 31/10/2016

Imzot ANGELO MASSAFRA o.f.m.

Do të kisha dashur që vetë Autori, i ndieri Atë Leonardo Di Pinto, françeskan i Provincës së Shën Mikelit Kryengjell të Fretërve Minorë të Puljes dhe të Molizës (Itali), të bente këtë prezantin. E bej une ne emërin e tij, jemi takuar heren e parë në vitin 1968.

Por ai është kthyer te Hyji dhe tani gëzon në shoqërinë e Martirëve tanë, historinë njerëzore dhe shpirtërore të të cilëve ka njohur dhe hartuar.

Ai ka bërë një punë të kujdesshme, të përpiktë dhe të shoqëruar me një nderim të madh për ata që, në tokë, kanë dëshmuar dashurinë për Hyjin dhe për Atdheun, duke dhënë jetën ndërsa thërrisnin “Rroftë Krishti Mbret! Rroftë Shqipëria!”.

Pra, botimi i këtij teksti është plotësimi i angazhimit të madh të Atë Leonardo-s, por, në të njëjtën kohë, një mirënjohje e popullit të krishterë shqiptarë ndaj këtij Frati.

Kështu, mendoj se nuk bëj mëkat mendjemadhësie nëse, në emër të Ipeshkvijve të Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, që përfaqësoj, të shpreh një falënderim të ngrohtë për Atë Leonardo-n me një kujtim mirënjohës ndaj personit të tij aq të mirë, ndaj miqësisë dhe simpatisë së tij për Kishën në Shqipëri dhe ndaj punës së tij kërkimore, përmbledhje e të cilës është kjo Vepër, *(edhe per kontributin per procesin e Martireve...pa Të, une nuk do te kisha filluar procesin!!)*. Ashtu si edhe për fretërit e Bashkësisë Françeskane të Barit, që i kanë mundësuar, qysh prej vitit 2000, të vinte shumë herë në Shqipëri dhe të harxhonte shumë kohë e energji për çështjen e Martirëve tanë.

Me siguri, vdekja e parakohshme e Atë Leonardo-s nuk i ka mundësuar ta përfundojë këtë vepër që, për këtë arsye, paraqitet e papërfunduar në stil dhe në disa detaje, që rishikuesit nuk kanë dashur t'i prekin shumë për respekt të autorit. Po për këtë arsye kemi vendosur ta shtypim kështu siç është, duke përkthyer prej origjinalit në gjuhën italiane materialet që ai na ka lënë, përfshi edhe disa prej referimeve të citimeve të librave që ai ka konsultuar.

Duke dashur ta botojmë këtë punim të Atë Leonardo Di Pinto-s O.F.M. në të njëjtën kohë me Lumturimin e Imzot Vinçenc Prennushit me Shokë, Martirë, qëllimisht është zëvendësuar terminologjia “Shërbëtorë të Hyjit”, që ai kishte përdorur kur po hartonte këto faqe, me “Të Lumë”. Po ashtu ky botim përkon edhe me shenjtërimin e Nënë Terezës së




Kalkutës dhe për këtë arsye është zëvendësuar terminologjia “E Lume” me “Shenjte”.

Sot promovojme në Tiranë, në këtë Universitet Katolik, këtë antologji biografish, që kemi botuar, në Shkodër e kemi promovuar me 26 tetor, me shpresën e gjallë që kujtimi i Martirëve dhe i virtyteve të tyre t'i shoqërojë gjithmonë brezat e rinj dhe t'u japë atyre koordinatat thelbësore për të qenë, qysh sot, Shqipëria e së nesërme. Për ta thënë me një slogan shumë në modë disa vite më përpara, “kujtimi bëhet profeci”. Por të rrënjosur mirë në të tashmen! Sepse është këtu dhe tani që fillon çdo vepër. Këtë kanë bërë Martirët tanë: në “këtu dhe tani”-në e tyre kanë shënuar fillimin e Shqipërisë së re, atë që jemi duke jetuar ne sot.

Falenderoj perseri atë Leonardon, gjithë bashkëpunëtorë, perkthyesit, redacionin, z. Fran Kullin, tipograf, Relatorët, Moderatoren, Universitetin dhe ju te pranishëm...

Tani, me gëzim dhe shpresë ia dorëzojmë këtë vepër krejt popullit shqiptar dhe, në mënyrë të veçantë, atyre që janë të thirrur të kujdesen për formimin e brezave të rinj, me qëllim që kujtimi i Martirëve të përçohet si motiv force dhe shprese gjithnjë të re; atyre që kanë përgjegjësinë e qeverisjes, me qëllim që të gjejnë aty urtinë dhe qortimin e nevojshëm për të kujtuar gjithmonë se personi njerëzor qëndron përpara çdo ligji dhe interesi ideologjik; ne ipeshkvijve, meshtarëve, rregulltarëve dhe rregulltareve, që njohja më e thellë e virtyteve heroike dhe shembulli i vëllezërve tanë të jetë nxitje për një dashuri



gjithnjë më të madhe për Hyjin, Kishën dhe popullin tonë; por edhe burim thirrjesh të reja për jetën meshtarake, rregulltare dhe misionare.

Në fund, uroj sinqerisht që përmbajtja e këtyre faqeve t'i ndihmojë zemrat shqiptare që të rrahin edhe më fort dhe, edhe pse kushtet kanë ndryshuar, në ta të tingëllojë sërish fort klithma e Martirëve tanë: “Rroftë Krishti Mbret! Rroftë Shqipëria!”.

FALEMINDERIT.

Në kontakt me natyrën: ditë falënderimi ndaj Hyjit

Mbi shëtitjen në Pezë të bashkësisë së Lëvizjes së Fokolarëve

Ishte Parku i Pezës që mirëpriti mbi 80 pjesëmarrës që me 19 qershor, u takuan së bashku në ditën e *Lëvizjes së Fokolarëve*. Një familje e madhe: fëmijë, edhe të sapolindur, adoleshentë, të rinj, të rritur deri në moshën më të pjekur (të moshuar). Qëllimi? U mbloodhën për të falënderuar Zotin i cili është i pranishëm në mesin e bijëve të tij, që jetojnë urdhërin e dashurisë së ndërsjelltë. Në një farë mënyrë ishte edhe mbyllja e veprimtarive të vitit, duke pasur parasysh që për shkak të pushimeve, ndoshta (me shumicën) do ritakohemi vetëm në shtator.

Dashuria e Atit përjetohej jo vetëm me anë të pejsazhit që befason me bredhat shekullorë, me livadhet e mirëmbajtura, ose ndoshta edhe për kohën e butë, gati e freskët në një verë shpesh tepër të nxehtë dhe të lodhshme të Tiranës, por para së gjithash nga përvoja e ripërtirë e bashkimit që na bën vëllezër në Krishtin. Është e rëndësishme të krijojmë dhe të rikrijojmë bashkësinë, si na thotë Chiara Lubich, themeluesja dhe udhëheqësja jonë, dëshmi e përbashkët e të gjithë atyre që në gjithë botën jetojnë idealin e njësisë. Besojmë që vëllazëria të cilën e jetojmë ndër pjestarë dhe miq të Fokolarëve, na bën të aftë të japim ndihmën tonë të posaçme në Kishë e në shoqëri për të cilin jemi të thirrur; ndez dhe ruan flakën e Dashurisë duke përhapur një mesazh uniteti, paqeje, vëllazërimi dhe shprese.

Në programin e kësaj dite përveç shëtitjeve, sportit dhe bisedave personale e në grup, nuk mund të mungonin lojrat bashkësiore. Dreka me zgarë – përgatitur me kujdes dhe përkushtim nga miq të palodhshëm – ka dhënë energjitë fizike të nevojshme, që janë “harxhuar” në këtë ditë të bukur dhe të pasur në mënyrë të shëndetshme, në mes gjelbërimit.

Ndërsa largoheshim, natyrshëm mund të kujtonim shprehjen e ungjilltarit: “Mos druaj, o grigjë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqeu t’ju japë Mbretërinë!” (Lk 12,32)... fjalë që mund t’i



kujtojmë dhe rijetojmë së bashku, me të gjithë besimtarët e bashkësisë së Dioqezës sonë dhe me të gjithë të krishterët, që dallohen falë dashurisë së ndërsjelltë, reciproke.

Jini një familje

Nëse sot do t’imë duhej ta lija këtë Tokë dhe do t’imë kërkoni një fjalë, si të fundit që shpreh Idealin tonë, do t’ju thoja – e sigurt se do ta kuptoni në thelbin e saj -: Jini një familje.

Ndodhen mes jush ata që vuajnë prova shpirtërore dhe morale? Kuptojini si një nënë dhe më shumë se një nënë, ndriçojini me fjalën ose me shembullin tuaj.

Bëni që të mos u mungojë ngrohtësia e familjes, përkundrazhi shtojeni ngrohtësinë përreth tyre.

Ndodhen mes jush ata që vuajnë fizikisht? Le të jenë ata vëllezërit tuaj të përzgjedhur. Vuani me ta. Përpiguni t’i kuptoni në thellësi dhimbjet e tyre. Përfshijini në frytet e jetës suaj apostolike derisa ta dinë se ata kanë kontribuar më shumë se kushdo tjetër.

Ndodhen ata që vdesin? Imagjinoni të jeni ju në vendin e tyre dhe bëni për ta atë që do të dëshironit

t’ju bëhej juve deri në çastin e fundit.

Ndodhet dikush që gëzon për një sukses ose për çfarëdolloj arsyeje tjetër? Gëzoni me të, që ngushëllimi i tij të mos hidhërohet dhe shpirti të mos mbyllet, por gëzimi të jetë i të gjithëve.

Është dikush që nisët? Mos e lini të largohet pa ia mbushur zemrën me një pasuri të vetme: kuptimin e familjes, që ta çojë atje ku shkon.

Mos vini kurrë, asnjë veprimtari tjetër të çdo lloji, as shpirtëror, as apostolik, ndaj shpirtit të familjes me ata vëllezër/motra me të cilët jetoni.

Dhe ku të shkoni për të çuar idealin e Krishtit... asgjë më të mirë nuk do të bëni sesa të përpiguni të krijoni me maturi, me kujdes, por me vendosmëri, shpirtin e familjes. Ai është një shpirt i përvuajtur, do të mirën e të tjerëve, nuk mburret... është, pra, dashuria vëllazërore e vërtetë, e plotë. Me një fjalë, nëse do të largohesha nga ju, do të lija që Jezusi në mua t’ju përsërisë: Duajeni njëri-tjetrin... derisa të gjithë të jenë një.

Kjara Lubik
25 dhjetor 1973



Përshkrimi i Logo-s së Martirëve në Shqipëri

Logo-ja më së pari është një rreth.

Rrethi: Simbol qiellit, i botës shpirtërore, i botës së përtejshme në mardhënje dialektike me Tokën. Simbol i hyjnisë, Alfa dhe Omega. Simboli i të përkryerës, të palëvizshmes. Paraqet Amshimin. Në fakt tre rrahtë të ngjitur me njëri-tjetrin simbolizojnë Trininë e Shenjtë.

Logo-ja ka ngjyrën e Artë, nuancën e së Artës.

Ngjyra: Ngjyrat kanë një simbolizëm të përcaktuar.

E Artë: Është imazhi i diellit, simboli i Dritës. Imazhi i Dritës, si burim jete, është në Krishterim në disa versione të Lajmërimit; në ikonografinë e krishterë është shndërruar në të verdhë të artë të aureolave.

Të krishterët e parë me ngjyrën e **Artë** simbolizojnë **Krishtin**, si Dritë të botës.

E kuqja, e Purpurta: Është ngjyra e serafinëve, simbol i dashurisë Hyjnore. Martirizimi. Është ngjyra e Mbretit, e Veshjes së Krishtit.

Kryqi dhe Palma.

Kryqi: Nuk është vetëm simbol i pemës së jetës, por është *pema e jetës*. Edhe pse dru i thatë është bërë i njomë dhe i frytshëm prej Gjakut të Krishtit, i cili duke vdekur mundi vdekjen e dhuroi jetën. Fryti i pemës së kryqit është Shëlbimi, Krishti Zot. Kryqi është djepi i jetës së re.

Palma: Perfiguron, që në fillesat e krishterimit, martirin. Pemë gjithmonë e gjelbër dhe e njomë. Mendohej që palma duke lulëzuar dhe duke dhënë fryte, dmth farën, do të thahej, por ndodh e kundërta, jep një jetë tjetër, kështu edhe martiri, duke dhënë jetën e vet nuk thahet, nuk është i pafryt, por bëhet farë për të krishterët e tjerë. Domethënia e palmës është ajo e fitores, e ngritjes, e rilindjes dhe e pavdeksisë. Pikërisht atëherë kur duket më e thatë, ajo lëshon farën e frytit



të saj dhe fillon procesi i ringritjes dhe i ringjalljes.

Në logo-n tonë, Kryqi dhe Palma kanë të njëjtën pikënisje, normalisht të stilizuar, nga një anë Kryqi i thatë dhe vend i flijimit, i cili bëhet i njomë me gjakun e Krishtit, kurse palma, nga ana tjetër, merr domethënien e plotë të simbolit të martirit pikërisht tek këmbët e kryqit duke u bërë pemë e lulëzuar dhe e njomë.

Ndërlidhja e ngjyrës së artë me atë të bardhë, do të tregojë që, përveç të artës, ngjyra tjetër është ajo që ia jep vendi i aplikimit të saj, dmth ambjenti i jetës, mishërimi në kontekstin e secilit njeri dhe secilës kohë.

Në të gjithë këtë gjithëpërfshirje domethënesh, simbolesh të ndryshme ndërlidhet mirë edhe jeta e secilit nga Martirët tanë, që nuk e deshën jetën e vet aq sa ta dronin vdekjen. Ata i dhanë dëshmi (μαρτυρεῖν), të *artës*, Hyjit të vërtetë duke marrë pjesë në mundimet e *Kryqit*, Djepi i jetës. Ata shpallën të *Kryqëzuarin*, (e *kuqja e purpurte*), duke mbajtur në duar *palmën* e fitores që ua jep pikërisht fitorja e Atij që vdiq

mbi kryq dhe e bëri pemë të jetës.

Edhe didaskalia, **Lumnimi i Shërbëtorëve të Hyjit Imzot Vinçenc Prennushi, ofm dhe 37 Shokët Martirë**, është lënë qellimisht brenda këtij konteksti domethënesh, ku niset nga këmbët e kryqit dhe futet në zemrën e palmës së fitores.

Semantika e përdorimit të fjalës *Lumnim* na ka shtyrë të bëjmë këtë zgjedhje fonetike. Fjala *Lumnim* ka në vete dy kuptime: **Konceptin teologjik** që ka fjala greke μακάριος, në kuptimin e parë si *fitim i të amshuemes*, por edhe **ilustrimin e konceptit tokësor** të *Lumturisë*, në kuptimin e dytë të fjalës μακάριος, si fat i pasurisë materiale tokësore. Ndërsa *Lumturimi* nuk na del asnjëherë në kontekst religjioz.

Spektri Semantik është vendimtarë në zgjedhjen e kësaj *fjale*. Veç kësaj, tradita është po aq vendimtare. Pra ajo që na bën për të anuar nga kjo zgjedhje është *Semantika e përdorimeve kontekstuale* dhe *tradita e përdorimit* të kësaj fjale.